



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 85, Datë 19.03.2026

MBI

MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “ENER TRADE” SH.P.K. PËR KRIJIMIN E LLOGARISË NË REGJISTRIN ELEKTRONIK TË GARANCIVE TË ORIGJINËS

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 22 të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; nenit 6 të “Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 300, datë 30.12.2024; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.03.2026, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, me nr. 863/1 prot., datë 18.03.2026 “Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “ENER TRADE” sh.p.k. për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës”,

Konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “ENER TRADE” sh.p.k.

- Shoqëria “ENER TRADE” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike me vendimin e bordit të ERE-s nr. 226 datë 26.10.2018, i ndryshuar dhe veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike me vendimin e bordit të ERE-s nr. 227, datë 26.10.2018, i ndryshuar.

2. Korrespondenca dhe Dokumentacioni i Depozituar nga Shoqëria

- Shoqëria “ENER TRADE” sh.p.k., me shkresën me nr. 863 prot. datë 10.03.2026, ka paraqitur pranë ERE-s kërkesën për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës, në përputhje me nenin 6 të “Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 300, datë 30.12.2024.
- Shoqëria ka përcjellë të plotësuar, duke specifikuar të dhënat identifikuese sipas kërkesave të nenit 6, pikës 4.1 të rregullores.

3. Analiza Ligjore dhe Vlerësimi

- Në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, ERE është organi kombëtar lëshues i garancive të origjinës dhe mban një regjistër elektronik për qëllime të lëshimit dhe administrimit të këtyre certifikatave.
- Vlerësohet se kërkesa përmbush të gjitha kriteret për hapjen e llogarisë në regjistër si furnizues/tregtar i energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë “ENER TRADE” sh.p.k. për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “ENER TRADE” sh.p.k. lidhur me vendimin e bordit të ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI